

MARRËVESHJE PËR SHITBLERJEN E KUOTAVE

TË SHOQËRISË CSA SHPK

Në Tiranë sot më datë 09 Tetor 2020 (Dymijë e njëzet) midis ortakëve të shoqërisë CSA SHPK me NUIS L81625017U u nënshkrua nga palët marrëveshja si më poshtë vijon:

Z.Denis Pulaha, lindur në Tiranë më 17.08.1983 dhe banues në Tiranë i identifikuar me dokumentin e identitetit kartë identiteti me Nr. personal me I30817032U dhe në vijim referuar si **"Shitësi Denis Pulaha"**

DHE

Z. Gjergji Vejsati, lindur në Tiranë, më 03.12.1978, banues në Tiranë identifikuar me kartë identiteti me numër personal Nr H81203034W në vijim referuar si **"Blerësi"**.

Shitësi dhe Blerësi do t'i bëhet referim në këtë Marrëveshje (në vijim referuar si **"Marrëveshja"**) veçmas si **"Pala"** dhe së bashku si **"Palët"**.

MEQENËSE

Në përputhje me këtë Marrëveshje, Blerësi është i interesuar të blejë nga Shitësi, i cili është i interesuar të shesë një pjesë të kuotave të pjesëmarrjes që zotëron në shoqërinë **CSA Sh.p.k.** (**"Shoqëria"**), NUIS L81625017U, me seli në adresën Njësia Administrative nr. 5, bulevardi "Bajram Curri", ndërtesa 138, hyrja 31, apartamenti 14, 1019 Tiranë, Shqipëri;

Për sa më sipër, Palët bien dakord si më poshtë vijon:

1. Parashtrimet dhe shtojcat

- 1.1** Parashtrimet dhe shtojcat janë pjesë përbërëse dhe plotësuese e kësaj Marrëveshje.

2. Objekti i Marrëveshjes

- 2.1** Sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, Shitësi i shet dhe i kalon Blerësit një pjesë të Pjesëmarrjes që zotëron në Shoqëri dhe Blerësit që pranon të blejë një pjesë të Pjesëmarrjes duke paguar çmimin e shitjes, të parashikuar në këtë Marrëveshje, si më poshtë specifikohet:

Shitësi i shet dhe i transferon tek Blerësit si më poshtë:

Blerësit **Z. Gjergji Vejsati** një pjesë të pjesëmarrjes që korrespondon me 20% të kapitalit të shoqërisë me vlerë nominale prej 2.000,00 Lek për blerjen e kësaj kuote do të paguhet vlera prej 2.000 Lek.

- 2.2** Pas këtij transferimi, kapitali i Shoqërisë do të përbëhet nga 2 (Dy) kuota si vijon:



Z. Denis Pulaha lindur në Tiranë më 17.08.1983 dhe banues në Tiranë i identifikuar me dokumentin e identitetit kartë identiteti me Nr. personal me I30817032U zotëron 1 (një) kuotë të barabartë me 50% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale të barabartë prej 5.000 Lek.

Z. Gjergji Vejzati, lindur në Tiranë, më 03.12.1978, banues në Tiranë identifikuar me kartë identiteti me numër personal Nr H81203034W, zotëron 1 (një) kuotë të barabartë me 50 % të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale të barabartë prej 5.000 Lek.

3. Kalimi i titullit të pronësisë mbi Pjesëmarrjen

- 3.1** Kalimi i titullit të pronësisë mbi Pjesëmarrjen nga Shitësi tek Blerësi do të ndodhë me marrjen e pagesës së kuotave nga blerësit.

4. Çmimi i shitjes


- 4.1** Palët bien dakord se çmim total i shitjes që Blerësi do t'i paguajë Shitësit për blerjen e Pjesëmarrjes është i barabartë me vlerën nominale të saj, e barabartë me 2.000 Lekë.
- 4.2** Palët deklarojnë se në datën e kësaj Marrëveshje Blerësi kanë shlyer detyrimin sipas pikës 3.1 të kësaj marrëveshjeje për të likuiduar vlerën e kuotave(si është përcaktuar në pikën 4.1) të blera.

5. Të ndryshme

- 5.1** Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet me pëlqimin e përbashkët me shkrim të Palëve. Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji shqiptar. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin mes Palëve në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 5.2** Kjo Marrëveshje përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet, komunikimet dhe deklaratimet e mëparshme ndërmjet Palëve.
- 5.3** Ndryshimet dhe shtesat e mundshme të kësaj Marrëveshje (përfshirë shtojcat e saj) do të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhen me shkrim, në gjuhën italiane dhe shqipe, dhe nënshkruhen nga Palët.
- 5.4** Kjo Marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet nga Palët në 2 (dy) ekzemplarë me vlerë të njëjtë secili.

PËR CSA SHPK

SHITËSI


Z. Denis PULAHA

BLERËSI


Z. Gjergji Vejzati